



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 20 shtator 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: ElmiReçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Teuta Rugova.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Artan Murati, Jeta Krasniqi dhe Eugen Cakolli - KDI, Gurjeta Zeka - LVV, Lumnije Murati - ZPRK dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: ElmiReçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9 gusht 2016;
3. Takim me përfaqësues nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI);
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9 gusht 2016

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 9 gusht 2016.

3. Takim me përfaqësues nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Elmi Reçica njoftoi se kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë me memorandumin e mirëkuptimit të nënshkruar në mes të KDI-së dhe Kuvendit të Kosovës. Në kuadër të këtij memorandumit tha se, janë parashikuar aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punës së Kuvendit, Qeverisë dhe agjencive të formuara nga Kuvendi, por njëkohësisht edhe mbikëqyrja e dialogut Kosovë-Serbi.

Jeta Krasniqi i njoftoi se KDI-ja ka një bashkëpunim të rregullt me Kuvendin, duke ofruar mbështetje, asistencë dhe ekspertizë hulumtuese. Lidhur me memorandumin e mirëkuptimit tha se është bërë me qëllimin për të afruar asistencë ndaj deputetëve, grupeve parlamentare, si dhe komisioneve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi. Ky dialog tha se është një proces delikat dhe ajo çfarë synojmë të arrijmë përmes këtij projekti është që ta ndihmojmë Kuvendin dhe deputetët që ta bëjnë sa më të efektshme mbikëqyrjen e këtij procesi. Asistenca do të jetë në formën e vizitave në terren, hulumtimeve parlamentare, bashkëbisedim me qytetarët dhe kësisoj të rritet edhe pjesëmarrja e qytetarëve në këtë dialog. Sa i përket projektit njoftoi se është i mbështetur dhe i financuar nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë dhe është paraparë edhe një ndihmesë nga Parlamenti i Zvicrës, ku do të diskutohen modalitetet e negociimit, kalimi i krizave politike dhe çështje të tjera të rëndësishme të lartë politike.

Artan Murati- tha se kemi vërejtur që qytetarët po ndjehen të shkëputur nga procesi i dialogut dhe ne dëshirojmë t'iu afrojmë afërsi me qytetarët përmes tryezave, përmes daljes në terren, dhe përmes sjelljes së qytetarëve në Kuvend. Ajo çfarë kërkohet nga deputetët është që të jenë bashkëpunues dhe të marrin pjesë në aktivitetet që do të organizohen.

Zafir Berisha dyshoi lidhur me kapacitetet dhe mundësitë për ta përcjellë dhe monitoruar këtë proces shumë delikat, i cili ka qenë i mbyllur për opinionin. Si deputet tha se përmes mjeteve të informimit njoftohet lidhur me këtë proces, ndërsa KDI-ja në vazhdimësi është në Kuvend, por sa kanë kapacitet për ta përcjellë këtë proces të mbyllur. Është mirë të njoftohemi se çfarë është duke bërë Qeveria e Kosovës në raport me bisedimet tepër të dëmshme që është duke i zhvilluar në Bruksel, tha z. Berisha.

Puhie Demaku- tha se është më se e nevojshme një tentim qasje në këtë proces, i cili ka qenë tepër i mbyllur. Nga ky bashkëpunim pret të ngritët transparenca e procesit të dialogut, i cili ka qenë i mbyllur dhe të ngritët llogaridhënia sepse komisioni në vazhdimësi, pa dashjen tonë, ka dështuar të marrë llogari nga qeveria dhe ministritë përkatëse lidhur me këtë proces. Për ta ndjekur vazhdimësinë, realizimin dhe zbatimin e marrëveshjeve tha se ne duhet të dimë se çka

janë marrë vesh në Bruksel, andaj kërkoi që të ketë një pako informuese, ngase deputetëve iu është mohuar mundësia që t'i shohin marrëveshjet. Ky projekt, tha se është në të mirë të vendit, dhe dëshiron që të jetë i suksesshëm, duke cekur se skepticizmi dhe vullneti për bashkëpunim nuk do të mungojnë.

Blerta Deliu-Kodra- tha se kjo është një nismë e mirë, pavarësisht skepticizmit që mund ta kemi, dhe hapi që ka bërë KDI-ja bashkë me Kuvendin është një hap përpara, drejt rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Shprehu mendimin se, si të zgjedhur kanë nevojë që t'ua bëjnë të qartë qytetarëve se çka është nënshkruar në Bruksel dhe cilat janë përfitimet e qytetarëve të Kosovës nga marrëveshjet e nënshkruara. Kërkoi nga KDI-ja që të afrojë ekspertizën e saj, në mënyrë që deputetët të kenë qasje të hapur sa i përket procesit të dialogut, po ashtu njoftoi se bashkë me znj. Demaku është pjesë e projektit të mbështetjes së Parlamentit të Zvicrës.

Qerim Bajrami-tha se bashkëpunimi dhe mbështetja nga KDI na është e njohur dhe shpreson se edhe në këtë komision do të ketë bashkëpunim të mirë. Lidhur me bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, tha se të gjithë i dinë vështirësitë, por ne duhet që të gjejmë mënyra se si t'i tejkalojmë ato. Z. Bajrami tha se kemi nevojë për vënien e raporteve me Bosnjën dhe Hercegovinën, dhe në këtë drejtim kërkoi që KDI t'i kushtojë rëndësi kësaj çështjeje për të gjetur një zgjidhje të mundshme.

Luljeta Veselaj-Gutaj- tha se e përshëndetë këtë iniciativë bashkëpunimi sepse grupeve parlamentare, komisioneve, por edhe deputetëve i duhet më shumë bashkëpunim dhe ekspertizë në fusha të caktuara. Shprehu mendimin se memorandum i është jashtëzakonisht i mirë dhe të fillojë të funksionojë për së mbari, sepse qytetarët presin më shumë transparencë, presin sa më shumë diskutime dhe sqarime jo vetëm rreth marrëveshjeve, por rreth çdo gjë që punohet në Kuvend.

Ismet Beqiri- Tha se padyshim që nevoja për transparencë asnjëherë nuk është e mjaftueshme, në kuptimin që asnjëri prej nesh nuk jemi të kënaqur asnjëherë me atë çfarë iu prezantojmë qytetarëve.

Sa i përket dialogut bisedimet asnjëherë nuk janë të dëmshme, por është me rëndësi të dihet se çfarë po bisedohet, çfarë po realizohet dhe sa po transmetohet ajo në opinion, me këto ne, si deputetë, nuk mund të jemi të kënaqur. Për projektin tha se është një avancim, të cilin e vlerëson dhe është shumë e qartë që ne duhet t'i ndajmë detyrat se kush kujt i jep llogari. Unë nuk mund të jem i kënaqur me nivelin e llogaridhënies dhe padyshim që ka hapësirë për përmirësim në këtë drejtim. Z. Beqiri, ndër të tjerash foli edhe për diplomacinë parlamentare, duke shtuar se deputetët duhet të jenë më aktivë në këtë drejtim, sepse kjo e bënë të mundur që deputetët të jenë më të kyçur dhe më aktiv jo vetëm në dialog, por edhe në gjitha punët e institucioneve.

Elmi Reçica- tha se ne kemi një pajtueshmëri politike që dialogu duhet të vazhdojë, por duhet të ekzistojë mbikëqyrja e dialogut dhe involvimi i deputetëve.

Jeta Krasniqi falënderoi anëtarët e Komisionit për gatishmërinë e tyre për ta mbështetur këtë projekt të përbashkët që çështja e dialogut të bëhet më transparente dhe të njoftohen me tepër qytetarët lidhur me të. Suksesi i jonë në këtë projekt tha se nuk do të varet vetëm nga ne, por edhe nga pjesëmarrja e juaj dhe gatishmëria e juaj. Ne duke i ditur të gjitha sfidat e barrierat që mund t'i kemi, kemi dizajnuar edhe programe e mekanizma të tillë që mund t'i shtyjme përpara edhe ekzekutivin për ta shtuar llogaridhënien por në të njëjtën kohë edhe ta fuqizojmë rolin e deputetit të Kosovës dhe qasjen më të drejtpërdrejtë me qytetarët. KDI tha se ka një ekspertizë goxha të madhe, të cilën e arrijnë përmes kontraktimit të ekspertizave të jashtme. Ne, në të njëjtën kohë, kemi synim që platformën online "Vota ime" ta hapim për dialogun dhe të krijojmë një platformë të veçantë për dialogun, ku do të jenë të plasura të gjitha marrëveshjet dhe mund të bëhet edhe monitorimi i rolit të deputetëve në mbikëqyrjen e Qeverisë.

Artan Murati- tha se synimi kryesor i këtij projekti është funksionalizimi i trekëndëshit të llogaridhënies prej ekzekutivit në legjislativ, e pastaj prej legjislativit te qytetarët. Për ta ngritur llogaridhënien e Qeverisë ndaj Kuvendit kemi paraparë aktivitete specifike, që t'ju asistojmë deputetëve me hartimin e pyetjeve parlamentare edhe me përgatitje me interpelanca dhe se do të ndihmojnë në mbikëqyrjen e Qeverisë, për çdo gjë që do të kenë nevojë deputetët. Ai po ashtu tha se do të mbajnë në vëzhgim se si është qasja e deputetëve karshi qytetarëve në procesin e dialogut.

Puhie Demaku duke cekur se më parë u tha që ka konsensus në këtë Komision lidhur me këtë projekt dhe me formën, e dialogun, theksoi se këtu ka konsensus vetëm për faktin që ne kemi mungesë të transparencës, nevojës për transparencë dhe llogaridhënies. Kërkoi nga përfaqësuesit e KDI të informojnë se a kanë marrë nga ana e Qeverisë përkushtimin për bashkëpunim, qoftë edhe me marrjen e masave ndëshkuese për ata që nuk i realizojnë premtimet e tyre në raport me këtë marrëveshje.

Jeta Krasniqi – tha se edhe pse projekti ka fokus më të madh në punën e deputetëve, kemi pasur disa takime me ministren e dialogut dhe kemi hasur në një gatishmëri të shprehur nga ana e tyre për këtë projekt dhe për të parë mënyrat e bashkëpunimit në mënyrë konkrete. Jemi duke diskutuar edhe me ata se si të bashkëpunojmë, sikurse me Kuvendin. Pas fuqizimit të rolit të deputetëve prioritet në të njëjtën kohë është edhe fuqizimi i bashkëpunimit në mes të Kuvendit e Qeverisë përmes të tryezave të rumbullakëta në rajone të ndryshme të Kosovës.

Blerta Deliu- Kodra i njoftoi se krahas këtij projekti, Kuvendi i Kosovës ka tri vjet, që në kuadër të Departamentit për Politikë të Jashtme të Zvicrës, është pjesë e projektit për qeverisje të mirë të Zvicrës, në të cilën deputetët marrin pjesë aktive në takime të shumta që organizohen për çështje të dialogut. Në këto takime janë munduar të prekin konkretisht marrëveshjet e nënshkuara. Projektin e KDI-së e përkrah dhe e sheh si një nismë të mirë.

4. Të ndryshme

Zafir Berisha kërkoi që të ftohet në raportim nga Komisioni, ministri Hoxhaj për të na sqaruar shumë çështje nga puna në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Raportimi i ministrit është i paraparë edhe me Planin e punës së Komisionit, tha z. Berisha.

Pas propozimit për ftesë për raportim të ministrit të Jashtëm, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Të ftohet për të raportuar në Komision ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj.

Elmi Reçica propozoi që Komisioni të realizojë vizitën zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ashtu siç është e paraparë me Planin e Punës së Komisionit.

Pas propozimit për realizimin e vizitës së Komisionit në Shqipëri, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Të realizohet vizita zyrtare e Komisionit në Republikën e Shqipërisë.

Qerim Bajrami propozoi që në mbledhjen e radhës, të shqyrtohet plani i punës së Komisionit. Ai po ashtu propozoi që në takimin e radhës në mes të pozitës e opozitës të organizuar nga z. Rashiti, të ftohen edhe grupet e tjera parlamentare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

ElmiReçica